

VENDIM
Nr. 331, datë 12.4.2017

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT QENDROR TË MONITORIMIT *ON-LINE* (SQMO) QË DUHET TË PAGUAJNË SHOQËRITË E LICENCUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, 70, pika 12, të ligjit nr.155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të kreut VI, të vendimit nr.647 datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kritereve të përzgjedhjes të operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*, që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ministri i Financave vazhdon procedurën për lidhjen e kontratës me shoqërinë e shpallur fituese, sipas kushteve teknike, afateve të implementimit të projektit të përcaktuara në ofertën e shpallur fituese.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LIDHJA 1

Kategoria	Tarifa e mirëmbajtjes	
“Baste sportive”	Tarifa ditore prej 0.70 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo qendër basti	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0,5% ose (0,005)
“Lotaria Kombëtare”	Tarifa ditore prej 1.00 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo operator	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000)
“Kazino elektronike”	Tarifa ditore prej 1.25 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo aparaturë elektronike	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000)

